# SYLLABUS I LËNDËS " E DREJTA E PROCEDURËS CIVILE I"

| **Të dhëna bazike të lëndës** | |
|---|---|
| **Njësia akademike:** | **Fakulteti Juridik** |
| **Titulli i lëndës:** | **E Drejta e procedurës civile I, pjesa kontestimore** |
| **Programi:** | **Juridik i përgjithshëm** |
| **Niveli:** | **Bachelor** |
| **Statusi lëndës:** | **Obligative** |
| **Viti i studimeve:** | **III** |
| **Numri i orëve në javë:** | **3+2** |
| **Vlera në kredi – ECTS:** | **7** |
| **Koha / lokacioni:** | **Koha/lokacioni (termini i mbajtjes së ligjëratës dhe salla), si dhe detaje të tjera do te caktohen në bashkëpunim me Fakultetin** |
| **Mësimdhënësi i lëndës:** | **Prof. Asoc. Dr. Berat Aqifi** |
| **Të dhënat kontaktuese:** | **e-mail: berat.aqifi@uni-prizren.com** |
| | |
| **Përshkrimi i lëndës:** | Lënda "E drejta procedurale civile 1" ka të bëjë kryesisht me të drejtën procedurale kontestimore dhe atë me fillimin, zhvillimin dhe përfundimin e procedurës kontestimore. Në këtë lëndë do të trajtohen edhe çështjet e procedurës sipas mjeteve të goditjes së vendimeve dhe procedurat e veçanta kontestimore. |
| | |
| **Qëllimi i lëndës:** | Qëllimi kryesor i kësaj lënde është që studentët pranë UKZ-së të marrin njohuri të mjaftueshme nga lënda e procedurës civile si pjesë e drejtës pozitive që përmban të gjitha rregullat juridike sipas të cilave mbrohen të drejtat subjektive-civile, dhe atë përmes bashkëpunimit të ndërsjellë të gjykatave dhe organeve tjera, që bëjnë zbatimin e së drejtës materiale. Me anë të kësaj lënde, për studentët e shkencave juridike, synohet të arrihen këto qëllime themelore:të ofrohen njohuritë themelore për institutet e së drejtës të procedurës civile nëpërmjet parimeve themelore të procedurave civile, llojeve, subjekteve të procedurës lidhur me veprimet, kompetencat dhe organizimeve të gjyqeve sipas ligjit dhe organeve tjera pjesëmarrëse në procedurë deri te përfundimi dhe nxjerrja e aktgjykimit, goditja e tyre me mjete juridike, si dhe përmbarimi i tyre në procedurë të veçante gjyqësore sipas Ligjit. |
| | |
| **Rezultatet e të nxënit**: | Në përfundim të lëndës "E drejta procedurale civile" studentët do të jenë në gjendje të kuptojnë konceptin në të ardhmen të jenë në gjendje që permes njohurive te perfituara te ngrisin ne nivel me te larte shkallen e tyre rreth njohjes së legjislacionit aktual, lidhur me procedurën kontestimore qe |

| | |
|---|---|
| | kane te bejne me te gjitha fazat neper te cilat kalon si lloj i procedurës gjyqësore civile.<br>E gjithë kjo do të arrihet përmes marrjes së njohurive duke filluar naga nocioni bazuar në parimet e përgjithshme e tutje me qellim të formimit te nje juristi ne te ardhmen.<br>• Studentet do te kene mundesinë që me një qasje logjike dhe ne menyre analitike t'i zgjidhin çeshtjet që kanë të bëjnë me të drejtat civile, përmes procedurale civile ne aspektin e argumentimit dhe qasjes kritike lidhur me situatat e krijuara të problemeve lidhur me institutet e së drejtës civile në Kosovë. |

| **Ngarkesa e studentit (duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)** | | | |
|---|---|---|---|
| **Aktiviteti** | **Orë** | **Ditë/javë** | **Gjithsej** |
| Ligjërata | 3 | 15 | 40 |
| Ushtrime teorike/laboratorike | 2 | 15 | 30 |
| Punë praktike | 1 | 15 | 15 |
| Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet | 10 min | 15 | 1.5 |
| Ushtrime në terren | 4 | 4 | 16 |
| Kollokfiume, seminare | 1 | 1 | 1 |
| Detyra të shtëpisë | 2 | 13 | 26 |
| Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi) | 2 | 15 | 30 |
| Përgatitja përfundimtare për provim | 2 | 15 | 30 |
| Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuis,provim final) | 4 | 1 | 4 |
| Projektet, prezantimet ,etj | 10 | 1 | 10 |
| **Totali** | | | **200 orë (7 ECTS)** |

| | |
|---|---|
| **Metodologjia e mësimdhënies:** | Në kuadër të programit të lëndës, metodë kryesore e vlerësimit mund të jetë:<br>• Prania në ligjërata krahasuese;<br>• Konsultime;<br>• Ushtrime të realizuara me sukses;<br>• Testi me shkrim-me gojë;<br>• Punë praktike e realizuar;<br>• Punimet seminarike;<br>• Punë në terren;<br>• Projekte të realizuara në punëtorit edukative; |
| **Metodologjia e vlerësimit:** | Kollokium dhe provim final.<br> Vlerësimi i parë: 30% |

| | |
|---|---|
| | Vlerësimi i dytë 25%<br>Detyrat e shtëpisë ose angazhime tjera 10%<br>Vijimi i rregullt 5%<br>Provimi final 30%<br>Total 100%<br>Vlerat e pikëve:<br>Provimi ka 100 pikë.<br>50-60 = 6; 61-70 = 7; 71-80 = 8; 81-90= 9; 91-100 = 10<br>Pikët nën 50 nuk mbërrijnë notën kaluese. |
| **Literatura** | |
| **Literatura primare:** | 1. Faik Brestovci, Iset Morina, Rrustem Qehaja, E drejta procedurale civile I, Prishtinë 2015.<br><br>**Ligje:**<br><br>- Ligji nr. 03/L-006, për procedurën kontestimore, Prishtinë, 2008;<br><br>- Ligji nr. 04/L-118, për plotësimin ndryshimin e ligjit për procedurën civile kontestimore, Prishtinë, 2012;<br><br>- Ligji për Gjykatat (Secili student duhet të ketë me vete tekstet ligjore në ligjërata dhe ushtrime) |
| **Literatura shtesë:** | Komentari i Ligjit të Procedurës Civile I, pjesa kontestimore: Linku: http://jus.igjk.rks-gov.net/508/ |

| **Plani i dizajnuar i mësimit:** | | |
|---|---|---|
| **Java** | **Ligjërata** | **Ushtrime** |
| *Java e parë:* | Përmbajtja e programit lëndor:<br>• Hyrje në të drejtën procedurale civile;<br>• Emërtimi i të drejtës procedurale civile | Hyrje prezentim i lëndës |
| *Java e dytë:* | E drejta procedurale civile,<br>• nocioni,<br>• llojet dhe burimet juridike në Kosovë<br>• burimet juridike nacionale dhe BE; | Diskutim rreth nocionit, llojeve dhe burimeve të procedurës civile kontestimore në Kosovë dhe BE. |
| *Java e tretë:* | Raporti midis procedurës kontestimore dhe procedurave tjera<br>• Parimet e procedurës kontestimore; | Elaborim i raporteve midis procedures civile kontestimore dhe procedurave të tjera. |
| *Java e katërt:* | Subjektet e procedurës kontestimore,<br>• pjesmarrësit në procedurën kontestimore,<br>• përbërja, kompetenca, llojet; | Diskutim përmes rastit praktik lidhur me subjektet e procedurës civile kontestimore. |
| *Java e pestë:* | Organet tjera që marrin pjesë në ushtrimin e gjyqësisë,<br>• avokateria publike),<br>• palët dhe përfaqësimi i tyre; | Rast praktik, lidhur me organet e tjera që marrin pjesë në ushtrimin e gjyqësisë. |

| | | |
|---|---|---|
| *Java e gjashtë*: | Veprimet procedurale;<br>• afatet, seancat,<br>• kërkesa për dhënjen e aktgjykimit, | Vështrim i posaçëm i veprimeve procedurale, si afati, seancat etj. |
| *Java e shtatë:* | Padia<br>• Llojet e padive sipas Ligjit; | Sqarim i legjislacionit përmes prezentimit të shkresës konrektisht padis dhe llojet e padis. |
| *Java e tetë:* | • Kolokuiumi I-rë | • Kolokuiumi I-rë |
| *Java e nëntë:* | Zhvillimi i procedures kontestimore sipas Ligjit në Kosovë; | Diskutim rreth zhvillimit të procedurës kontestimore sipas Ligjit në Kosovë. |
| *Java e dhjetë:* | Bashkimi i kërkesëpadive dhe i subjekteve procedurale<br>• pjesëmarrja e personave të tretë në gjykim;. | Rast praktik lidhur me bashkimin e kërkespadive dhe i subjekteve procedural. |
| *Java e njëmbëdhjetë:* | Shqyrtimi kryesor i qështjes juridike në procedurë kontestimore sipas Ligjit; | Diskutim bazuar në shqyrtimin kryesor të qështjes juridike në procedurë civile kontstimore bazuar në Ligjin e procedurës Civile kontestimore. |
| *Java e dymbëdhjetë:* | Të Provuarit,<br>• nocioni,<br>• objekti<br>• mjetet provuese në procedurë kontestimore sipas Ligjit; | Rast praktik lidhur me të provuarit, kryesisht lidhur me mjetet e të provuarit sipas ligjit të procedurës civile kontestimore. |
| *Java e trembëdhjetë:* | Forma e vendimeve në procedurë kontestimore;<br>• Aktgjykimet dhe<br>• Aktvendimet, llojet e tyre; | Diskutim rreth formës së vendimit në procedures civile kontestimore |
| *Java e katërmbëdhjetë:* | Procedura sipas mjeteve të<br>• rregullta të goditjes së<br>• vendimeve në procedurë<br>• kontestimore;<br>• Procedura sipas mjeteve te jashtëzakonshme të goditjes së vendimeve në procedurë kontestimore; | Diskutim përmes rasteve praktike lidhur me mjetet e goditjes së vendimeve në procedurë civile kontestimore. |
| *Java e pesëmbëdhjetë:* | • Kollokuiumi II-të | • Kollokuiumi II-të |

**Politikat akademike dhe kodi i sjelljes**

- Respektimi i orarit në ligjërata dhe ushtrime
- Mos lëshimi i sallës gjatë ligjëratave ose ushtrimeve;
- Ruajtja e integritetit akademik;
- Ruajtja e disiplinës gjatë procesin mësimor;
- Respektimi i rregullave gjatë provimit.